

INFORMACIONI I STANDARDIZUAR PARAKONTRAKTOR I QIRASE FINANCIARE (INDIVIDE)

"Kujdes! Qira financiare kushton para"

Emri dhe detajet e kontaktit të bankës

Banka	Porsche Leasing
Adresa	Autostrada Tiranë-Durrës, Km.7, Rr.Monun, Tiranë, Albania
Numri i Telefonit	+355 (04) 450 08 28
Adresa e postës elektronike	info@porscheleasing.al
Adresa e Web-it	www.porscheleasing.al

1. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të produkteve të kredisë

Lloji i kredisë	Lizing financiar, për të lehtësuar blerjen e mjeteve motorike (automjete) per kliente individe dhe retail
Vlera totale e financimit nga Porsche Leasing dhe monedha	23,590.00 EUR Financimi lëvrohet vetëm në monedhën EUR
Nëse është e aplikueshme Financimi nga është në monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat	Në monedhë të ndryshme nga të ardhurat ☐ Në të njëjtën monedhë me të ardhurat ☐
Nëse është e aplikueshme Vlera e kështit të kredisë, e shprehur në monedhën në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat, mund të ndryshojë.	Kësti i qirasë është i shprehur në monedhën EUR Klienti Qiramarrës do të marrë një njoftim në rastet kur si rezultat i ndryshimit të kursit të këmbimit, kësti i qirasë (psh: 100,00EUR) tejkalon vlerën (psh 120,00EUR) - rasti kur të ardhurat e klientit janë në monedhën lek . Në rast të këtij ndryshimi, nuk është e nevojshme të lidhet një aneks i veçantë i marrëveshjes. Qiradhënesi do të njoftojë me shkrim Qiramarrësin lidhur me këto ndryshime. Në se këto ndryshime, do të sjellin si rezultat rritjen e kështit të qirasë, me më shumë se 20%, palët do të kenë të drejtë të zgjidhin Kontratën e Qirasë Financiare.
Kushtet që rregullojnë tërheqjen e automjetit	Porsche Leasing, do të kryejë një pagesë të vetme të fondeve tek furnizuesi PORSCHE ALBANIA SHPK, per cmimin e blerjes së objektit të qirasë brenda 5 ditëve nga lidhja e kontratës së Qirase Financiare dhe kryerjes së pagesës së parë (parapagimi dhe kësti i pare dhe komisionit të administrimit).
Periudha e financimit	36 muaj
Këstet dhe, kur është e mundur, mënyra se si do të shlyhen këstet	Shuma e kështit: 7.863,33 EUR Numri i kësteve: 36 Periodiciteti i pagesave të kështit: mujor
Shuma totale që konsumatori do të ketë për të paguar:	34.112,81EUR Informacion i detajuar mbi pagesat e Qiramarrësit jane paraqitur në paragrafin: Elementet e ofertës për Qiranë Financiare

Nëse është e aplikueshme Garanci/siguri të nevojshme	Garancia/instrumenta garancie për financim: Dorëzania (nese aplikohet) Llojet e instrumentave të garancisë do të përcaktohen nga vlerësimi përfundimtar i aftësive paguese të klientit Qiramarrës dhe do të jenë përcaktuar qartë, në marrëveshjen e qirasë financiare që do të nëshkruhet me klientin.
---	--

2. Kostoja e kredisë

Norma e interesit të kredisë që do të aplikohet në kontratën e kredisë.	Norma e interesit mbi shumën e financimit dhe të pashlyer, do të jetë si më poshtë: Norma Nominale e Interesit 0.00 % (variabel) është e përbërë nga: Marzhi fiks: -2.14% Indeksi Orientues/Euribor 3M prej: 2.14% Norma Nominale e Interesit është variabël (e ndryshueshme) dhe do të llogaritet për shumën e papaguara të kësteve mujore mbi bazën EURIBOR 3M (ku EURIBOR do të thotë: Kursi i Ofruar në Tregun Ndërbankar European me maturim 3 Mujor). Llogaritja e interesit do të fillojë nga data e dorëzimit të mjetit, që do të përcaktohet në aktin e dorëzimit të automjetit dhe do të mbarojë një ditë pune më vonë nga ripagimi i plotë i shumës së financimit nëse vlera e mbetur është paguar ose kur objekti është kthyer mbapsht. Norma e Interesit e llogaritur për tremujorin e parë do të bazohet në normën e EURIBOR 3M të përcaktuar në datën e lidhjes së kësaj Kontrate. Në vijim Qiradhënësi, do të rregullojë normën e interesit me ndryshimet në EURIBOR 3M katër herë në vit: çdo datë 20.02. (20 shkurt), 20.05. (20 maj), 20.08. (20 gusht) dhe 20.11. (20 nëntor), vetëm nëse ka një ndryshim të EURIBOR-it tre mujor me më shumë se $\pm 0.25\%$ pikë në përqindjeje në raport me vlerën e EURIBOR-it 3 Mujor në ditën e rregullimit të mëparshëm të normës së interesit. Në këtë rast, Qiradhënësi do të marrë masat të njoftojë qiramarrësin për ndryshimin në normat e interesit me shkrim, (postë ose postë elektronike), jo më vonë se 7 ditë përpara datës së caktuar për pagesën e kështit të qirasë me normën e ndryshuar të interesit, së cilës, i bashkëlidhet edhe plani i pagesave, i ndryshuar.
Norma efektive e interesit (NEI) <i>Është totali i kostos së kredisë për klientin, e shprehur si përqindje vjetore e vlerës së kredisë së dhënë dhe e llogaritur në përputhje me nenin 6 dhe aneksin nr. 1 të rregullores nr. 59 "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare".</i>	Norma Efektive e Interesit (NEI) është 0.90% Kjo normë NEI i referohet normës aktuale në ditën e lëshimit të dokumentit të informacionit parakontraktor. Megjithatë, vlera e saktë e NEI-t, do të shprehet në planin e pagesave, i cili do t'i dorëzohet Qiramarrësit ditën e dorëzimit të automjetit. Norma Efektive e Interesit NEI, është totali i kostos së financimit për klientin Qiramarrës e shprehur si përqindje vjetore e vlerës së financimit të dhënë. Kostoja totale e kredisë për klientin është totali i të gjitha shpenzimeve ku përfshihen interesat, komisionet dhe çdo lloj tjetër shpenzimi, që klienti paguan për kredinë sipas kushteve të marrëveshjes së Qirasë Financiare (shpenzimet për komisionin e administrimit, për marrëveshjen e Qirasë Financiare).

	Sqarimi i detajuar i përllogaritjes së NEI paraqitet si më poshtë me një shembull ilustrues: Shuma e kredisë është 1000 euro, e ripagueshme në dy shuma, secila prej 600 eurosh, e pagueshme respektivisht pas një dhe dy vitesh. Ekuacioni shndërrohet: $1000 = \frac{600}{(1+i)^{164}} + \frac{600}{(1+i)^{328}} = \frac{600}{(1+i)^{164.275}} + \frac{600}{(1+i)^{328.550}}$ $= \frac{600}{(1+i)^{32}} + \frac{600}{(1+i)^{64}} = \frac{600}{(1+i)^{32}} + \frac{600}{(1+i)^{64}}$ $= \frac{600}{(1+i)^2} + \frac{600}{(1+i)^2}$ nga ku $i = 0.13066$ e rrumbullakosur në 13.1% (ose 13.07 % nëse preferohet një saktësi në dy shifra dhjetore).																																
Elementët e ofertës për Qiranë Financiare	Emri dhe mbiemri i Qiramarrësit: Adresa e qiramarrësit: x Norma Nominale e Interesit (variabël): 0.00% Lloji i objektit të qirasë: Automjet i ri Marka dhe lloji: VW New Golf PA 2.0TDI <table border="0"> <tr> <td>(01) Vlera bruto e blerjes së automjetit me qira</td><td>33.700,00 EUR</td></tr> <tr> <td>(02) Vlera Neto e objektit të dhënë me qira</td><td>28.083,33 EUR</td></tr> <tr> <td>(03) TVSH e e objektit të dhënë me qira</td><td>5.616,67 EUR</td></tr> <tr> <td>(04) Parapagimi 30.00% e cmimit të blerjes</td><td>10.110,00 EUR</td></tr> <tr> <td>(05) Shuma e financimit</td><td>23.590,00 EUR</td></tr> <tr> <td>(06) Vlera e mbetur e objektit të qirasë</td><td>0,00 EUR</td></tr> <tr> <td>(07) Shuma që amortizohet me këste</td><td>23.590,00 EUR</td></tr> <tr> <td>(08) Interesi total</td><td>0,00 EUR</td></tr> <tr> <td>(09) Periudha e financimit</td><td>3</td></tr> <tr> <td>(10) Kësti mujor</td><td>7.863,33 EUR</td></tr> <tr> <td>(11) Shuma totale e kësteve të qirasë</td><td>23.589,99 EUR</td></tr> <tr> <td>(12) Komisioni i administrimit (1,75)%</td><td>412,82 EUR</td></tr> <tr> <td>(13) Pagesa totale për qiradhënësin</td><td>34.112,81 EUR</td></tr> <tr> <td>* (04)+(06)+(11)+(12)</td><td></td></tr> <tr> <td>(14) Pagesa e parë përpara dorëzimit të mjetit</td><td>10.522,82 EUR</td></tr> <tr> <td>* (04)+(12)</td><td></td></tr> </table>	(01) Vlera bruto e blerjes së automjetit me qira	33.700,00 EUR	(02) Vlera Neto e objektit të dhënë me qira	28.083,33 EUR	(03) TVSH e e objektit të dhënë me qira	5.616,67 EUR	(04) Parapagimi 30.00% e cmimit të blerjes	10.110,00 EUR	(05) Shuma e financimit	23.590,00 EUR	(06) Vlera e mbetur e objektit të qirasë	0,00 EUR	(07) Shuma që amortizohet me këste	23.590,00 EUR	(08) Interesi total	0,00 EUR	(09) Periudha e financimit	3	(10) Kësti mujor	7.863,33 EUR	(11) Shuma totale e kësteve të qirasë	23.589,99 EUR	(12) Komisioni i administrimit (1,75)%	412,82 EUR	(13) Pagesa totale për qiradhënësin	34.112,81 EUR	* (04)+(06)+(11)+(12)		(14) Pagesa e parë përpara dorëzimit të mjetit	10.522,82 EUR	* (04)+(12)	
(01) Vlera bruto e blerjes së automjetit me qira	33.700,00 EUR																																
(02) Vlera Neto e objektit të dhënë me qira	28.083,33 EUR																																
(03) TVSH e e objektit të dhënë me qira	5.616,67 EUR																																
(04) Parapagimi 30.00% e cmimit të blerjes	10.110,00 EUR																																
(05) Shuma e financimit	23.590,00 EUR																																
(06) Vlera e mbetur e objektit të qirasë	0,00 EUR																																
(07) Shuma që amortizohet me këste	23.590,00 EUR																																
(08) Interesi total	0,00 EUR																																
(09) Periudha e financimit	3																																
(10) Kësti mujor	7.863,33 EUR																																
(11) Shuma totale e kësteve të qirasë	23.589,99 EUR																																
(12) Komisioni i administrimit (1,75)%	412,82 EUR																																
(13) Pagesa totale për qiradhënësin	34.112,81 EUR																																
* (04)+(06)+(11)+(12)																																	
(14) Pagesa e parë përpara dorëzimit të mjetit	10.522,82 EUR																																
* (04)+(12)																																	
A është e mundur të përfitohet kredia sipas kushteve të punës në të cilat tregtohet, duke përjashtuar: -kontratat e sigurimit për kredinë?	Gjatë të gjithë kohëzgjatjes së Kontratës së Qirasë Financiare, Qiramarrësi, në përputhje me afatet dhe kushtet e shoqërisë së sigurimit, do të lidhë një kontratë për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësisë (TPL) dhe sigurim plotësues për drejtuesin e automjetit dhe pasagjerët (KASKO) duke mbuluar riskun nga aksidentet, vjedhja e automjetit dhe mashtrimi (kundër zjarrit, fatkeqësive natyrore, përmytjeve, thyerjes, etj.). Kontratat e sigurimit do të jënë pjesë përberëse e Kontratës së Qirasë Financiare. Qiramarrësi do të ketë të drejtë të zgjedhë shoqërinë e sigurimit dhe formën e sigurimit, me kusht që shoqëria e sigurimit dhe forma e sigurimit të pranohen nga Qiradhënësi . Kostot e sigurimit përballohen drejtpërdrejt nga Qiramarrësi.																																

Kosto të tjera të lidhura me financimin e automjetit	Kosto të tjera që lidhen me financimin e automjetit përfshijnë shpenzimet për regjistrim, kontroll teknik dhe taksa vjetore sipas Legjislacionit në fuqi dhe kosto materiale, lidhur me nënshkrimin e Kontratës së Qirase Financiare
Çdo kosto shtesë që është e detyrueshme për përfitimin e kredisë.	Komisioni i administrimit, do të jetë në masën 1,75% e shumës së financimit të automjetit, që përkon me vlerën 412,82EUR, TVSH e përfshirë.
<i>Nëse është e aplikueshme</i> Shuma e kostove për përdorim të caktuar të një pagese (p.sh. një kartë krediti).	Nuk ka
<i>Nëse është e aplikueshme</i> Ndonjë kosto tjetër që rrjedh nga kontrata e kredisë.	Po Duke qenë se kontrata e Qirase Financiare lidhet me financim automjeti, klienti Qiramarrës duhet të marrë në konsideratë kostot që lidhen me mbarëvajtjen e mjetit gjatë periudhës së përdorimit si: taksat periodike vjetore dhe kontrolli teknik i automjetit sipas Legjislacionit në fuqi në Shqipëri, dhe kosto të tjera në kuadër të mirëmbajtjes teknike të automjetit, sipas manualit të prodhuesit.
<i>Nëse është e aplikueshme</i> Kushtet, sipas të cilave kostot e siperpermendura që kanë të bëjnë me kontratën e kredisë mund të ndryshojnë.	Nuk ka
<i>Nëse është e aplikueshme</i> Detyrimi për të paguar shpenzimet materiale.	Po Kosto e shpenzimeve materiale, sipas Legjislacionit në fuqi në shumën 8.600,00 lekë (TVSH e përfshirë)
Kostot në rastin e pagesave me vonesë. Mungesa e pagesave të kësteve mund të sjellin pasoja të rënda për konsumatorin dhe e bëjnë procesin e mbajtjes së kredisë më të vështirë.	Në rast të vonesave në pagesë Qiradhënësi ka të drejtë të aplikojë një kamatë vonesë në masën prej IR (Interes rate) + 2% në vit, duke filluar nga dita e parë e afatit të kamatvonesës (dita e parë pas maturimit të këstit përkatës) dhe deri në datën në të cilën kjo shumë e papaguar, paguhet e gjitha. Mënyra e llogaritjes, paraqitet si më poshtë, me një shembull ilustrues: Shembull: Kësti mujor: 200 Eur Data e lëshimit të këstit, sipas faturës tatimore të shitjes referuar planit të pagesave: 03.06.2021 Data e maturimit të këstit: 15.06.2021 Në rast se pas 17 ditës ose ditën e dytë të punës së muajit pasardhës nga data e lëshimit të këstit, (02.07.2021), në rast se klienti nuk ka kryer asnjë pagesë, Porsche Leasing ka të drejtën e lëshimit të kamatvonesës, skema e përllogaritjes do të jetë: Përllogaritje e interesit të vonesës = 200 Eur * 2 % * 17 ditë / 360 ditë = 0,19 Eur Klientit Qiramarrës i aplikohet penaliteti i parë: 10 Eur + 0.19 Eur = 10.19Eur Fatura përkatëse si dhe njoftimi me poste elektronike do t'i dërgohen klientit Qiramarrës. Në rast se pas ditës së 32-të të lëshimit të këstit të papaguar, Qiradhënësi konstaton se klienti nuk ka kryer asnjë pagesë, skema e përllogaritjes do të jetë: Përllogaritje e interesit të vonesës = (200 Eur * 2 % * 32 ditë / 360 ditë = 0,36 Eur Klientit Qiramarrës i aplikohet penaliteti i dytë: 15Eur + 0.36 Eur = 15.36Eur Fatura përkatëse si dhe njoftimi me poste elektronike do t'i dërgohen klientit Qiramarrës.

	Në rast se pas ditës së 47-të të leshimit të kështit të papaguar, Qiradhenesi konstaton se klienti nuk ka kryer asnjë pagesë, skema e përlogaritjes do të jetë : Përlogaritje e interesit të vonesës = 200 Eur * 2 % * 47 ditë /360 ditë = 0.53 Eur. Klientit Qiramarrës, i aplikohet penaliteti i tretë: 20Eur + 0.53 Eur = 20.53 Fatura përkatëse si dhe njoftimi me postë elektronike do t'i dërgohen klientit Qiramarrës. Ne rast mospagese dhe në përfundim të afateve të parashikuara në njoftimin e tretë , Porsche Leasing, i lind e drejta të zgjidhë kontratën në menyrë të njëanshme dhe të fillojë procedurat për rikuperimin e detyrimeve të pashlyera.
--	---

3. Aspekte të tjera të rëndësishme ligjore

E drejta për t'u tërhequr <i>Konsumatori ka të drejtë për t'u tërhequr nga kontrata e kredisë brenda një periudhe kohore prej 14 ditësh kalendarike.</i>	Qiramarrësi ka të drejtë të tërhiqet nga kontrata e Qirasë Financiare brenda 14 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës, pranë zyrës noteriale, pa treguar arsyen e tërheqjes. Qiramarrësi duhet të njoftojë me shkrim Qiradhënësin. Data e marrjes së njoftimit për tërheqje nga kontrata nga ana e Qiradhënësit, do të konsiderohet si data tërheqjes nga kontrata. Menjëherë pas dërgimit të njoftimit, Qiramarrësi, është i detyruar të kthejë objektin e qirasë pranë Qiradhënësit. Në momentin e dorëzimit, do të nënshkruhet procesverbal dorezimi, mes palëve. Në këtë rast, Qiramarrësi është i detyruar që menjëherë dhe jo më vonë se 30 ditë, të kompensojë dëmin e shkaktuar ndaj Qiradhënësit, duke i kompensuar këtij të fundit, diferencën ndërmjet vlerës së sendit të dhënë me qira (cmimit të blerjes) dhe vlerës së tregut të sendit të dhënë me qira të përcaktuara nga një vlerësues i autorizuar i Qiradhenesit, si dhe të paguajë interesin e aplikueshem, deri në datën e dorëzimit të mjetit sipas datës së procesverbalit të dorëzimit.
Shlyerja (pagesa) e kredisë para afatit të maturimit <i>Konsumatori ka të drejtë të kryejë në çdo kohë, para afatit të maturimit, shlyerjen e pjesshme ose të plotë të kredisë.</i>	Klienti ka të drejtën në çdo kohë të shlyejë të gjithë pjesën e mbetur të principalit të financimit të papaguar deri në atë kohë sipas kërkesës me shkrim drejtuar Qiradhënësit.
Mundësia e zëvendësimit të sendit/pasurisë (kolateralit)	Nuk ka
<i>Nëse është e aplikueshme</i> Çdo produkt/shërbim shtesë i ofruar nga banka së bashku me kontratën e kredisë dhe që nuk është përmendur në seksionet e mësipërme.	Nuk ka
<i>Nëse është e aplikueshme</i> Banka ka të drejtën e kompensimit, në rastin e shlyerjes së kredisë para afatit të maturimit.	Po, është e aplikueshme Komisioni i shlyerjes së financimit përpara afatit të financimit është në masën 2% mbi pjesën e mbetur të principalit + interes të mbetur të qirasë financiare të mjetit. Shembull: Komisioni i mbylljes do të jetë 2% e principalit të mbetur + interes Përlogaritja e komisionit: Vlera e mbetur e principalit : 10.900Eur; Interesi mbetur : 1300 Eur . Përlogaritje e komisionit të mbylljes se parakohshme: (10.900+1300) * 2% = 244Eur

Informimi në rast refuzimi të kredisë <i>Banka duhet të informojë konsumatorin, menjëherë dhe pa komisione, nëse një aplikim për kredi është refuzuar, duke i vënë në dispozicion arsyet mbi të cilat është bazuar ky refuzim. Kjo nuk aplikohet nëse dispozitat e këtij informacioni janë të ndaluara nga ligjet e Republikës së Shqipërisë.</i>	Porsche Leasing informon konsumatorin menjëherë dhe pa komisione, nëse një aplikim për qira financiare është refuzuar
Mënyra e njoftimit, si dhe mënyra e marrjes së pëlqimit të konsumatorit në rastin e ndryshimeve të kushteve, të cilat sjellin pasoja në bazë të kontratës.	Cdo njoftim, kërkesë dhe komunikim mes palëve, do të bëhet me shkrim dhe do të dërgohet me postë të regjistruar ose e-mail në adresat e depozituara pranë Porsche Leasing ose në adresat e njoftuara më pas nga secila prej palëve.
Skema e brendshme e ankimit të konsumatorit kundrejt bankës.	Klientët mund të paraqesin ankesë në tre mënyra komunikimi: 1. Me shkrim pranë zyrave të Porsche Leasing shpk; 2. Nëpërmjet e-mail: info@porscheleasing.al; 3. Duke telefonuar në numrin +355 (04) 450 08 28
Periudha kohore gjatë së cilës banka ka detyrim që rrjedhin nga informacioni parakontraktor.	Informacioni i shfaqur, është i vlefshëm në datën e lëshimit të këtij formulari parakontraktor. Ky informacion është paraprak dhe jepet në bazë të kërkesës nga ana e aplikantit. Porsche Leasing rezervon të drejtën, që pas përpunimit të dokumenteve dhe vlerësimit të aftësive paguese sipas procedurave të brendshme, të ndryshojë kushtet e financimit. Në këtë rast, aplikantit, do ti jepet sërish informacioni i rifreskuar, në një formular të ri parakontraktor.

Konsumatori
(Konfirmon marrjen e informacionit parakontraktor)

(Emër Mbiemër, Nënshkrimi)

Datë/Muaj/Vit: _____ / _____ / _____

PËR RREZIKUN E KURSIT TË KËMBIMIT PËR KREDINË NË MONEDHË TË NDRYSHME NGA AJO E GJENERIMIT TË TË ARDHURAVE

Financimi në një monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën gjenerohen të ardhurat, për konsumatorin që nuk është i mbrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit, shoqërohet me rreziqe të konsiderueshme. Për shembull, një nënçmim i fortë i kursit të këmbimit, do të shkaktonte vështirësi në aftësinë e konsumatorit për të shlyer financimin e automjetit. Ky aneks përmban një shembull me natyrë ilustruese dhe informuese, dhe nuk përfaqëson një pritshmëri apo angazhim ligjor nga kredithënësi apo kredimarrësi. Konsumatori që aplikon për financim në një monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën gjeneron të ardhurat, nëpërmjet nënshkrimit të këtij dokumenti vërteton se:

- 1) e ka marrë këtë dokument nga banka përpara lidhjes së kontratës së kredisë.
- 2) e ka kuptuar shembullin dhe efektet e mundshme nga lëvizjet në kursin e këmbimit;
- 3) është i bindur që mund të përballojë rreziqet që shoqërojnë kredinë.

Dokumenti i nënshkruar nuk e detyron Porsche Leasing për dhënien e financimit për automjet dhe as nuk e redukton përgjegjësinë që ka Porsche Leasing për të kryer analizën e saj të plotë për qëndrueshmërinë financiare të aplikuesit për financim.

Të dhëna për kredinë në rastin kur monedhë të ndryshme nga monedha e gjenerimit të të ardhurave

Qiramarrësit: VW GOLF VIII 0%	Lloji i kredisë: Lizing financiar
Kohëzgjatja e kredisë: 3 muaj	Shuma e financimit: EUR 23.590,00
Njësia monetare: EURO	Kursi i këmbimit, në datën e vlerësimit të planit ilustrues: 95,97
Kundërvlera e kredisë në monedhën në të cilën gjeneron të ardhurat:	2.263.932,30LEK
Norma efektive e interest: 0,00%	EURIBOR 3M: 2,14% Marzhi: -2,14%

Të ardhurat mujore (bruto/neto) të huamarrësit në monedhën në të cilën gjeneron të ardhurat (mesatare e 3 viteve të fundit): 100.000,00

Table 1: Kësti i kredisë dhe raporti i vlerës së kështit të kredisë ndaj të ardhurave (në %), sipas skenarëve të rrezikut të ndryshimit të kursit të këmbimit.

Skenari	Vlera e kështit e shprehur në monedhën e kredisë (a)	Kundërvlera e kështit në monedhën në të cilën gjenerohen të ardhurat (b)	Të ardhurat (mesatare mujore të 3 viteve të fundit) në monedhën në të cilën ato gjenerohen (c)	Raporti i vlerës së kështit ndaj të ardhurave ((d) = (b)/(c))
Kursi i këmbimit nuk ndryshon	95,97	754.643,78	100.000,00	754,64%
Nënçmim i kursit të këmbimit me 5%	100,77	792.375,97	100.000,00	792,38%
Nënçmim i kursit të këmbimit me 20%	115,16	905.572,54	100.000,00	905,57%

Qiramarrësi (Konfirmon marrjen e këtij shembulli ilustrues)

(Emër Mbiemër, Nënshkrimi)

Datë/Muaj/Vit: _____ / _____ / _____